



Procedurat pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë

| BACHELOR, Viti Akademik 2022-2023 / Kreu IV/1 | | Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit |
|--|--|--|
| 1. | Kreu IV/1, pika 1 Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, kanë të drejtë të aplikojnë pranë IAL-ve. | 02.09.2022 – 13.09.2022 |
| 2. | Kreu IV/1, pika 11 IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar. | 17.09.2022 |
| 3. | Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 1 Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në shtojcën Nr.10. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së si dhe në faqet web përkatëse, e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr.8 të këtij udhëzimi. | 23.09.2022 |
| 4. | Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 2 IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi. | 24.09.2022 |
| 5. | Kreu IV/1, pika 14 IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar. | 27.09.2022 |
| 6. | Kreu IV/1, pika 15, fjalia 1 Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore në datat e përcaktuara, sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. | 07.10.2022 – 11.10.2022 |
| 7. | Kreu IV/1, pika 15, fjalia 2 Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës së përcaktuar . | 18.10.2022 |
| 8. | Kreu IV/1, pika 16 IAL-të brenda datës së përcaktuar, dërgojnë pranë QSHA-së, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. IAL-të nuk duhet të dërgojnë në QSHA të dhënat e asnjë kandidati pas kësaj date. Për të gjithë emrat kandidatë të dërguar pas kësaj date ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja duhet të kërkojë nga IAL-ja, duke njoftuar edhe kandidatin, çregjistrimin e tyre dhe konfirmimin me shkresë zyrtare brenda një afati 10 ditor për kryerjen e procesit të çregjistrimit të kandidatit nga IAL. | 15.12.2022 |